V E N D I M
Nr.40, datë 25.10.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli,	Anëtari	“ “
Veli Budo,	Anëtari	“ “
Zija Vuci,	Anëtari	“ “
Franc Jakova,	Anëtari	“ “
Alfred Karamuço,	Anëtari	“ “

me sekretare Drita Filto, në datën 9.10.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.42 Akti që i përket :

K Ë R K U E S : KESHILLI I RRETHIT MAT, i përfaqësuar nga Z.Ilir Gurabardhi.
SUBJEKT I INTERESUAR : KESHILLI I MINISTRAVE, i përfaqësuar nga Z. Zyher Beci.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i Vendimit nr.252, datë 22.4.1996 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ndarjen administrative tokësore të Republikës së Shqipërisë”, për këto shkaqe:

- Vendimi bie ndesh me dispozitat e Ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 dhe të Ligjit nr.7573, datë 16.6.1992;
- Nuk është marrë mendimi i Këshillit të Rrethit, siç parashikon ligji mbi organizimin e funksionimin e pushtetit lokal;
- Meqënëse ndarja administrative ka rëndësi të veçantë, e do krijojë në vazhdimësi probleme sociale, kërkohet zbatimi i Ligjit “Për referendumin”.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi kërkuesin, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Këshilli i Ministrave, me Vendimin nr.252, datë 22.4.1996 ka vendosur që Komuna e Martaneshit, me të gjitha fshatrat që përshihen në të dhe territorin përkatës, të shkëputet nga rrethi i Matit dhe të kalojë në përbërje të rrethit të Bulqizës. Këtë vendim, Këshilli i Ministrave e ka marrë në përputhje me kompetencat që i njohin dispozitat kushtetuese, e konkretisht pika 8 e nenit 36 të Ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Kompetencën e Këshillit të Ministrave për të vendosur për ndarjen administrative tokësore të Republikës së Shqipërisë e parashikon edhe Ligji nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, i cili në asnjë nga dispozitat e tij nuk e lidh këtë kompetencë me dhënien e pëlqimit nga këshilli i rrethit përkatës, ashtu siç pretendohet pa të drejtë nga kërkuesi.

Përsa i përket pretendimit të kërkuesit se për rastin konkret duhet të zhvillohet

referendum, Gjykata e sheh të nevojshme të vërë në dukje se kjo nuk hyn në kompetencën e saj.

Kërkuesi, në kërkesën e tij i referohet edhe Ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor”si dhe atë me nr.7573, datë 16.61.992 “Për zgjedhjet e organeve të pushtetit lokal”, duke pretenduar se vendimi i atakuar vjen në kundërshtim me ato. Gjykata konstaton se asnjë nga dispozitat e të dy ligjeve nuk rregullojnë problemet e ndarjeve administrative.

PËR KËTO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991”Për dispozitat kryesore kushtetuese”, njëzëri,

V E N D O S I :

Rrëzimin e kërkesës së Këshillit të Rrethit Mat.
Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.
U shpall sot, më datë 25.10.1996